



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 10.01.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.01.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NSH Smart Architecture" për aktivitetin "**Konkurs projektimi për konservimin dhe adaptimin e shtëpisë shkolle në Muzeun e shtëpive shkolle (Lagja e Herticeve, Prishtine)**" me Nr. të Prok: 616 -18-141-412 nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "NSH Smart Architecture" e datës 09.01.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Konkurs projektimi për konservimin dhe adaptimin e shtëpisë shkolle në Muzeun e shtëpive shkolle (Lagja e Herticeve, Prishtine)**" me Nr. 616 18 8816 412 Nr. Brendshëm : 616 -18-141-412 kundër *vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit të AK -së, të datës 24.12.2018 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.*
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te mbetet në fuqi vendimi i marre me date 24.12.2018.*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "N.SH Smart Architecture" me datë 09.01.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Konkurs projektimi për konservimin dhe adaptimin e shtëpisë shkolle në Muzeun e shtëpive shkolle (Lagja e Herticeve, Prishtine)**" me numër të prokurimit Nr. 616 18 8816 412 dhe numër të brendshëm 616 18 141 412.

Autoriteti Kontraktues, me datë 09.01.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Kerkesa refuzohet pasi qe eshte parashtuar pas skadimit te afatave kohore per  
parashtrim te kerkesave per rishqyretim

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit